



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Këshilli Shkencor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në mbështetje të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore dt. 28 mars 2013 (Gazeta zyrtare nr. 11/02 maj 2013) dhe Udhëzimit administrativ nr. 01/2017, dt. 30.01.2017 për mbështetjen financiare për aplikim të fondeve nga MASHTI për botime dhe publikime shkencore në revista me faktor ndikimi, shpall:

KONKURS

(Për financimin e botimeve dhe publikimeve shkencore në revista me faktor ndikimi për vitin 2024)

- MASHTI/ DALSh, mbulon shpenzimet e publikimeve për revista shkencore të indeksuara në Web of Science dhe Scoopus me faktorë ndikimi pozitiv të autorëve të cilët punën e tyre kërkimore e realizojnë në institucionet kërkimore-shkencore të Kosovës.
- Financohen botime / publikimet nga fushat prioritare shkencore të parapara në Programin Kombëtar të Shkencës:

Fushat shkencore prioritare për aplikim:

1. Burimet Natyrore, Energjia dhe Mjedisi.
2. Prodhimi Bujqësor.
3. Studimet Mjekësore.
4. Studimet Ekonomike dhe Sociale.
5. Studimet Gjuhësore, Kulturore dhe Historike.
6. Hulumtime ndërdisiplinare për Teknologjitë e Komunikimit dhe Informacionit.

Kush mund të aplikojë ?

- Aplikimet për botime/ publikime të veçanta bëhen vetëm prej personit fizik.
- Merren parasysh botimet/publikimet e individëve dhe institucioneve që e ushtrojnë veprimtarinë shkencore në Republikën e Kosovës.
- Aplikimi bëhet vetëm prej autorit të parë i punimeve të publikuara gjatë vitit akademik 2023/24 (01.10.2023-30.09.2024).

Për aplikim për botim duhet të plotësohen këto dokumente:

- **Letërnjoftimi i aplikuesit (kopja)**
- **Aplikacioni i plotësuar**
- **Autori duhet të dëshmoj me kopjen fizike të publikimit të punimit me header të revistes së publikimit të punimit në scopus ose në Web of science.**
- **Web faqen e printuar të publikimit të punimit në Scopus ose Web of science ku paraqitet emri i punimit, emri i autorit dhe viti i publikimit.**
- **Deklaratë e noterizuar nga autori që punimi nuk është i botuar pjesërisht apo tërësisht më herët dhe që nuk ka sponsorë të tjerë.**
- **Autori duhet ta dëshmoj transaksionin e pagesës në emër të tij.**

- Financohen vetëm dy punime të një autori të publikuara në revista që janë të indeksuara dhe të listuara në platformen Scopus dhe Web of Science brenda një viti.
- Për revistat e listuara në Q1 ose Q2 kompensimi bëhet deri në 80% të vlerës e jo më shumë se 1000€.
- Për revistat e listuara në Q3 ose Q4 kompensimi bëhet deri në 50% të vlerës e jo më shumë se 600€.
- Dëshminë nga Universiteti / Kolegji për punimin i cili nuk është rimbursuar nga ana e Institucionit ku autori punon.
- Kërkesat tjera në bazë të UA për botime dhe publikime shkencore në revista me if.

Konkursi mbetet i hapur nga:23.04.2024-26.09.2024

- Aplikacioni me dokumentacion të kompletuar dorëzohet në arkivin e MASHTI, zyra nr.4, ndërsa të gjitha informatat rreth aplikimit merren në zyrën nr. 302/b, kati 3 te; z. Fidan Kozhani.

Dokumentacionet e pakompletuara dhe aplikimi me vonesë nuk shqyrtohen

Detajet e kontaktit;

Emri: Fidan Kozhani

Posta elektronike :

e-mail: fidan.kozhani@rks-gov.net, Adresa postare :

Rr. Agim Ramadani p.n 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.+381(0) 38 200 20123